



Periodik mujor Nr. 182 Korrik 2024

**Në
këtë
periodik
në të lexoni:**

**Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive
e AMF-së raporton
në Kuvendin e Shqipërisë**

Tregu i sigurimeve, janar-qershor 2024

**Tregu i titujve të Qeverisë jashtë bursës për periudhën
janar-qershor 2024**

VËSHTRIM MBI TREGJET

ZHVILLIME TË TJERA

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

7 - 10

11-14

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë



Tiranë - 4 korrik 2024

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi prezantoi në Kuvendin e Shqipërisë raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2023. Znj. Kaçi bëri një pasqyrim të ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, zhvillimeve kryesore të vitit të kaluar, si dhe paraqiti disa nga drejtimit kryesore ku do të përqendrohet veprimtaria e Autoritetit për periudhën në vazhdim.

Në fjalën e saj znj. Kaçi evidentoi se gjatë vitit 2023 tregjet nën mbikëqyrje ecën në një trajektore të stabilizuar zhvillimi dhe rritje, me tregues të mirë të shëndetit financiar, ku totali i asetëve arriti vlerën prej rreth 108 miliardë lekë ose 12% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive theksoi rëndësinë e miratimit të dokumentit të strategjisë institucionale të Autoritetit për periudhën 2023-2027, si një udhërrëfyes i rëndësishëm në përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve strategjike të AMF.

Znj. Kaçi e cilësoi të suksesshëm vitin 2023, i cili shënoi progres në negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duke përfunduar me sukses procesin e screening, në të cilin AMF drejtoi Kapitullin 9 "Shërbimet financiare". Në Progres Raportin e Komisionit të BE për Kapitullin 9, Shqipëria shfaqet më e përparuar krahasuar me vendet që i kanë hapur më herët negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Vijon...

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

... vijon

Përgjatë vitit të kaluar është ecur drejt përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator me direktivat evropiane, duke përfshirë miratimin e Ligjit “Për fondet e pensionit privat” të përafruar me direktivën evropiane IORP II, i cili pritet të ndikojë në zgjerimin e tregut të fondeve të pensionit privat në vend. Gjithashtu, aktet nënligjore të miratuara në fushën e tregjeve të kapitalit rrisin transparencën dhe integritetin e tregut. Miratimi i rregulloreve për fondet e investimeve ka krijuar mundësi të reja për qytetarët shqiptarë që të investojnë në fonde të licencuara të BE-së. Gjithashtu, në tregun e sigurimeve ka nisur zbatimin e udhërrëfyesit për regjimin evropian të mbikëqyrjes Solvency II.

Më tej, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive nënvizoi raportin e vlerësimit të miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) në 2023, pas një procesi të gjatë dhe rigoroz vlerësimi mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në Sigurime, ku rezultoi një nivel i lartë përputhshmërie. Gjatë vitit 2023, Autoriteti vijoi thellimin e bashkëpunimit me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, rregullatorët e vendeve të rajonit dhe të BE-së, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përfitimin e asistencës teknike në drejtim të rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes dhe implementimit të praktikave më të mira.

Në përfundim të fjalës së saj, Znj. Kaçi theksoi drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin në vijim, të cilat bazohen në dokumentin “Strategjia 2023-2027”. Në fokus do të jenë kontributi i mëtejshëm në forcimin e stabilitetit financiar, përafrimi ligjor dhe rregullator me acquis të BE-së, mbështetja e zhvillimit, modernizimin dhe digjitalizimin të tregjeve, mbrojtja e konsumatorit si dhe ndërmarrja e nismave për financat e gjelbra.

Në fjalën e saj, zj. Kaçi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me institucione të tjera, si dhe bashkërendimin e aktiviteteve që synojnë ndërgjegjësimin e publikut dhe zgjerimin e kulturës financiare në vend.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – qershor 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - qershor 2024 kapën vlerën 11,880 milionë lekë, ose 7.55% më shumë se në janar - qershor 2023. Gjatë periudhës janar - qershor 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 699,453 me një rritje prej 9.62% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.31% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.64% dhe risigurimi me 0.048%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 44.08% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 55.92% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar - qershor 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,124 milionë lekë, ose 24.53% më shumë se në periudhën janar - qershor 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar - qershor 2024 kapën vlerën 2,910 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.84% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar – qershor 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar - qershor 2024 arritën rreth 6,643 milionë lekë, ose 9.49% më shumë se në periudhën janar - qershor 2023.

Zhvillimet e tregut të titujve të Qeverisë jashtë bursës për periudhën janar-qershor 2024

Të dhënat statistikore të tregut të titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar-qershor 2024, flasin për një dominim të transaksioneve “Marrje dhe transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 46.49% dhe 40.09% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë të realizuara jashtë Burse për periudhën janar-qershor 2024, u dominua në masën 68.38% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 31.62% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).


Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 85.09% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar-qershor 2024 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.10% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tre grupet e transaksioneve B, C dhe F

Transaksioni i llojit **B** “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere)” gjatë periudhës janar-qershor 2024, ka pasur një rritje prej 3,591 milionë lekë ose 133.21% krahasuar me periudhën janar-qershor 2023. Ndërkohë, numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 9.96%. Transaksioni i llojit **C** “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori)” gjatë periudhës janar-qershor 2024, ka pasur një rritje prej 19 milionë lekë ose 1.40%. Numri i transaksioneve është ulur me 5.04% krahasuar me periudhën janar-qershor 2023. Për transaksionin e llojit **F** “Ekzekutimi i urdhrat të klientit (jo nga dhe për llogari të portofolit të subjektit)”, gjatë periudhës janar-qershor 2024, janë realizuar transaksione me vlerë nominale 2 milionë lekë.

Tregu i titujve të Qeverisë jashtë burse, janar – qershor 2024 (Në %)



Në totalin e transaksioneve të llojit B, C dhe F të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 3,612 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-qershor 2023.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF zhvillon takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit



Tiranë – 3 korrik 2024

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, zhvilloi një takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit që operojnë në vend. Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e mendimeve dhe vendosjen e piketave të përbashkëta për të ecur drejt përbushjes së prioriteteve në sektorin e sigurimeve.

Znj. Kaçi paraqiti një përmbledhje të treguesve të 6-mujorit të parë të 2024 dhe sfidave të së ardhmes. Nga ana e Autoritetit u vlerësua qëndrueshmëria e tregut të sigurimeve, duke përfshirë rritjen e volumit të primeve të shkruara, diversifikimin e produkteve dhe përparimin drejt digjitalizimit. Përkundër zhvillimeve pozitive, u evidentuan disa sfida kryesore që kërkojnë angazhim të përbashkët mes Autoritetit dhe aktorëve të tregut, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i praktikave të trajtimit të dëmeve dhe pagesat brenda afateve.

Takimi u fokusua gjithashtu në sfidat e përbashkëta, si implementimi i standardeve ndërkombëtare dhe direktivave evropiane, të cilat kërkojnë angazhim dhe alokim të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemeve të reja. Në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në CEFTA, u theksua mbështetja e Autoritetit dhe e shoqërive të sigurimit për përbushjen e prioriteteve të përcaktuara nga shteti shqiptar.

Ky takim është një hap i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm drejt vizionit të përbashkët dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të sigurimeve në Shqipëri.

Takimi u fokusua në sfidat e përbashkëta, si implementimi i standardeve ndërkombëtare dhe direktivave evropiane, të cilat kërkojnë angazhim dhe alokim të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemeve të reja.

AMF zhvilloi analizën e punës së 6-mujorit të parë, 2024



Tiranë – 26 korrik 2024

Znj. Kaçi theksoi rëndësinë e kësaj analize si katalizator për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) zhvilloi analizën e punës për 6-mujorin e parë të vitit 2024, duke përcaktuar objektivat dhe piketat e veprimtarisë për pjesën e mbetur të vitit. Analiza u bazua në dy dokumente udhërrëfyese kryesore të Autoritetit: "Plani i Punës 2024" dhe "Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë".

Takimi u drejtua nga znj. Mimoza Kaçi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, ku drejtues të departamenteve e drejtorive të institucionit prezantuan punën dhe arritjet për 6-mujorin e parë të vitit 2024, si dhe prioritetet për muajt në vazhdim.

Znj. Kaçi theksoi rëndësinë e kësaj analize si katalizator për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale. Ajo nënvizoi se "çdo vendim që marrim, çdo rregullore që hartojmë, monitorimi i vazhdueshëm dhe mbikëqyrja që ushtrojmë, ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe investitorëve shqiptarë. Kjo përgjegjësi duhet të na udhëheqë në punën tone."

Në përmbyllje të tryezës së diskutimit, znj. Kaçi theksoi: "Tregu financiar zhvillohet me ritme të shpejta dhe ne duhet të jemi në pararojë të këtyre ndryshimeve, jo thjesht si reagues ndaj tyre, por me qëllim kryesor garantimin e stabilitetit, transparencës dhe besueshmërisë në tregjet financiare jobankare në vend."

Drejtues të lartë të Bankës Qendrore të Kosovës zhvillojnë një vizitë zyrtare në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare



Tiranë – 29 korrik 2024


Takimi u fokusua në tema me interes të përbashkët, duke përfshirë qasjen ndaj reformave që lidhen me IFRS 17, implementimin e regjimit mbikëqyrës Solvency II në sektorin e sigurimeve, etj.

Një delegacion i nivelit të lartë drejtues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) zhvilloi një vizitë zyrtare në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, znj. Mimoza Kaçi mirëpriti delegacionin e BQK-së, i cili kryesohej nga zëvendësguvernatori zoti Milot Cakaj. Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet kryesore në tregun financiar jo-bankar, duke përfshirë ndryshimet në kornizën ligjore dhe rregullatore si dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira mbikëqyrëse.

Takimi u fokusua në tema me interes të përbashkët, duke përfshirë qasjen ndaj reformave që lidhen me IFRS 17, implementimin e regjimit mbikëqyrës Solvency II në sektorin e sigurimeve, etj. Përfaqësuesit e BQK-së shprehën interes të veçantë për përvojën e AMF-së në fushën e tregut të kapitaleve dhe u diskutua lidhur me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave mes dy institucioneve.

Ky takim zhvillohet në vijim të vizitës që znj. Kaçi zhvilloi në Bankën Qendrore të Kosovës në shkurt të këtij viti, duke dëshmuar për marrëdhëniet e ngushta dhe forcimin e bashkëpunimit mes Autoritetit dhe BQK, me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen efektive të tregjeve financiare të dy vendeve.

Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”



Linku i projektregullores
gendet në:

https://amf.gov.al/pdf/fokus/Rregullorjaperformenpermbajtjenerapdhepasqyrave10_07_2024.pdf

Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶

Regullore “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë a depozitarit”;

Regullore “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”;

Materiali i plotë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 73/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren:

“Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”;

Projektregullorja e sipërpërmendur dhe shtojcat përkatëse janë publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

[“Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”](#)

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të tremujorit të parë të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto, në tremujorin e parë 2024 për siguruesit hungarezë arriti në 458 miliardë HUF ose rreth 1.2 miliardë euro. Kjo shifër tregon një rritje prej 8.62% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i Jetës zinte 33.3% të vëllimit total të primeve dhe sigurimet e Jo-Jetës 66.6% të vëllimit total të primeve.

Totali i dëmeve të shkaktuara (duke përmbledhur pagesat dhe ndryshimin e rezervave) u rrit me 0.7% duke arritur në 195 miliardë HUF. Dëmtimet e shkaktuara të lidhura me kontratat e sigurimit të Jetës arritën në rreth 107 miliardë HUF, ndërsa për sigurimet e Jo-Jetës arritën në 88 miliardë HUF.

Në fund të muajit mars 2024, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktive 22 sigurues: 4 sigurues të specializuar të Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të përbërë.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Sigurimeve të Qipros, IAC, tregu i sigurimeve në Qipro, në fund të tremujorit të parë 2024, arriti në 330 milionë euro, duke reflektuar një rritje prej 7.8% në terma vjetore. Dëmet e shkaktuara bruto u rritën me 10.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 143.1 milionë euro. Dëmet në kontratat e sigurimit të Jetës arrinin në 71.9 milionë euro dhe dëmet në sigurimin e Jo-Jetës arrinin në 71.2 milionë euro.

Gjatë tremujorit të parë 2024, vëllimi i primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimit të Jo-Jetës arriti në vlerën e 157.5 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 5.3% në terma vjetore. Ndërsa tregu i sigurimit të Jetës gjeneroi prime prej 172.5 milionë euro, ose 10.3% më shumë në terma vjetore.

MAQEDONI E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas publikimeve nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ASO) në Maqedoninë e Veriut, sigurimi shëndetësor privat ka qenë ndër sigurimet më të popullarizuar gjatë pesë muajve të parë të viti 2024, ndërkohë që sigurimi i pronës ka sjellë volumin më të madh të primeve të shkruara.

Gjatë pesë muajve të parë të vitit janë rritur edhe dëmet e paguara, duke arritur në vlerën e 1.95 miliardë denarë ose rreth 31.7 milionë euro. Kjo shifër shpreh një rritje prej 6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në klasat e sigurimeve vullnetare, produkti më i kërkuar dhe me rritje më të shpejtë është ende sigurimi shëndetësor privat (vullnetar), ku gjatë periudhës janar- maj 2024 u grumbulluan 687.7 milionë denarë ose 11.2 milionë euro. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, sigurimet shëndetësore janë rritur për 35%.

Rritje të ndjeshme ka edhe në sigurimin gjithëpërfshirës të automjeteve. Nga janari deri në maj 2024, kompanitë e sigurimeve kanë shitur polica në vlerë të përgjithshme prej 543 milionë denarë ose 8,83 milionë euro, që është 17% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Klasa më e madhe vullnetare është sigurimi i pronës, ku individët, institucionet dhe kompanitë kanë investuar 1.22 miliardë denarë, rreth 19.82 milionë euro, por ky segment ka shënuar rritje minimale prej 2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Nga ana tjetër, klasa më e madhe e sigurimeve të detyrueshme është sigurimi MTP, ku në pesë muajt e parë 2024 kompanitë kanë realizuar prime në vlerën e 2.21 miliardë denarë, rreth 36 milionë euro. Kjo do të thotë një rritje vjetore prej 7% për shkak të rritjes së numrit të automjeteve të siguruara.

Numri total i kontratave të sigurimit të lidhura nga janari në maj është rritur me 5% dhe ka kaluar shifrën 676,000 kontrata.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, në fund të marsit 2024, tregu slloven i sigurimeve, arriti në 746.2 milionë euro, duke shënuar një rënie prej 9.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto gjatë këtij tremujori, për tregun e sigurimit të Jetës shënoi një normë pozitive dyshifrore prej +10.1% duke arritur në 217.4 milionë euro. Ndërsa për tregun e sigurimit të Jo-Jetës vëllimi i primeve u ul me -15.8%, duke arritur në 529 milionë euro. Rënia më e madhe lidhet me rënien mbi 90% në sigurimet shëndetësore, nga 175 milionë euro në tremujorin e parë 2023, në rreth 15 milionë euro në fund të marsit 2024.

Sa i përket dëmeve të paguara, vlera totale e tyre ishte 450.9 milionë euro, nga 506 milionë euro një vit më parë. Nga ky vëllim i dëmeve, rreth 160 milionë euro dëme lidheshin me kontratat e sigurimit të Jetës, 145 milionë euro ishin pagesat për sigurimet motorike (MTPL dhe sigurimi Kasko) dhe rreth 65 milionë euro lidheshin me kontratat e sigurimet e pronës.

Java Botërore e Investitorëve të IOSCO-s 2024 do të fokusohet në teknologjinë dhe financat digjitale, asetet krypto dhe financat e qëndrueshme



Java Botërore e Investitorëve (WIW) është një fushatë globale njëjavore për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve

Java Botërore e Investitorëve (WIW) është një fushatë globale njëjavore për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve dhe për të nxjerrë në pah iniciativat e ndryshme të rregullatorëve të letrave me vlerë në këto dy fusha kritike.

WIW ka dy objektiva parësorë:

- (i) Të shpërndajë mesazhe kyçe që mbështesin edukimin e investitorëve, mbrojtjen e investitorëve dhe edukimin financiar; dhe
- (ii) Të nxisë mundësitë e të mësuarit për investitorët. Fushata synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin midis anëtarëve të IOSCO-s për iniciativat për edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve.

Duke filluar më 7 tetor 2024 përgjatë gjithë javës, organizatat që përfaqësojnë mbi 100 juridiksione do të mblidhen së bashku për të nxitur ndërgjegjësimin rreth çështjeve aktuale që ndikojnë tek investitorët në mbarë botën.

Temat kryesore përfshijnë:

- Teknologjinë & financat digjitale;
- Asetet krypto;
- Financat e qëndrueshme.

Këto tematika kryesore do të plotësohen me diskutime dhe seminare mbi:

- Parandalimi i mashtrimit;
- Qëndrueshmëria e investitorëve;
- Bazat e Investimit.

Vijon ...

Java Botërore e Investitorëve të IOSCO-s 2024 do të fokusohet në teknologjinë dhe financat digjitale, asetet kripto dhe financat e qëndrueshme

Z. Jean-Paul Servais, Kryetar i Bordit të IOSCO-s dhe Kryetar i Autoritetit të Shërbimeve Financiare dhe Tregjeve, të Belgjikës, tha: "Në Javën Botërore të Investitorëve të vitit të kaluar u përfshinë 118 juridiksione, duke arritur në pothuajse 730 milionë individë. Ashtu sikurse me avancimet teknologjike dhe me rritjen e përdorimit të Inteligjencës Artificiale lindin sfida të reja. Ne shohim se si janë kthyer në trend edhe tregtimi i kriptove. Jam i bindur se WIW 2024 do të bazohet në suksesin e viteve të mëparshme për të nxitur ndërgjegjësimin më të madh të investitorëve për këto çështje dhe mezi pres të kontribuojë në suksesin e saj."

Temat e këtij viti u miratuan nga Komiteti 8 i IOSCO-s, i cili kryen punën e tij mbi edukimin e investitorëve me pakicë dhe edukimin financiar dhe përfshin 38 anëtarë nga tregjet e krijuara dhe ato në zhvillim.

Z. Pasquale Munafò, Zyrtar i Lartë, Komisioner, Kombëtar për Shoqërinë dhe Bursën, Itali dhe Kryetar i Komitetit 8 të IOSCO-s, tha: "Temat kryesore që kemi identifikuar këtë vit janë rezultat i angazhimit të gjerë me të gjithë anëtarët e Komitetit 8 dhe pasqyrojnë njëzëri çështjet më urgjente me të cilat përballen investitorët sot. Ne gjithashtu bashkëpunojmë shumë ngushtë me komitetet e tjera përkatëse për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar për mbrojtjen dhe edukimin e investitorëve."

"Duke vendosur në qendër të vëmendjes këto fusha kritike, ne synojmë të fuqizojmë dhe mbrojmë investitorët në mbarë botën, duke u ofruar atyre njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të lundruar në një peizazh financiar gjithnjë e më kompleks."

Ashtu si në vitet e mëparshme, WIW 2024 do të mbështetet nga Bordi i Planifikimit të Standardeve Financiare (FSPB) me porosi "Dita Botërore e Planifikimit Financiar", e cila do të mbahet më 9 tetor.



Informacione shtesë për aktivitetet dhe mënyrën e pjesëmarrjes, gjenden në faqet web dhe rrjetet sociale:

www.worldinvestorweek.org

Facebook
@worldinvestorweek,

Twitter @ioscowiw

Instagram @ioscowiw





Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al